

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës:

Përgjegjës i Sektorit të Integritit dhe Marrëdhënieve Publike Drejtoria Juridike dhe Integritit

Procedura: **NGRITJE NË DETYRË / PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut III të VKM-së nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), njofton se:

- **Z. Klevis Limaj** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e ngritjes në detyrë/pranim nga jashtë shërbimit civil.

Konkurimi:

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **11.03.2024 ora 10:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **11.03.2024 ora 12:30**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyre në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **20** pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. **40** pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. **40** pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Përgjegjës i Sektorit të Integritit dhe Marrëdhënieve Publike**.

Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **11.03.2024**.

Njoftimi fituesit do të publikohet: në portalin e “Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **16.03.2024**.

Njësia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)